

Elektronika e Kuvendit, jo sipas Rregullores

[Gazeta Shqiptare, 11.3.2006]

Në Kuvend e në masmedia, idhtarët “e votimit me elektronikë” po prodhojnë vetëm sofizma. Sofizmi ku kanë ngecur më gjatë është si vijon: “Rregullorja e Kuvendit i pranon të dy mënyra si votime të fshehta, edhe atë “elektroniken”, edhe atë “me kuti”, prandaj nuk ka shkelje ligjore që u votua me kuti”. Në fakt, as formalisht nuk qëndron ky sofizmi i lejimit të kryerjes së votimit të fshehtë, me “impiantin elektronik të votimit që disponon aktualisht Kuvendi”, pra edhe formalisht është shkelur Rregullorja—po i lëmë shkeljet e Kushtetutës, e të parimeve të demokracisë, se tashmë kemi folur boll për to.

Duke iu përgjigjur sofistëve, me mënyrat e tyre:

Në nenin 60, pika 3, e Rregullores, shkruhet: “*Votimi i fshehtë bëhet duke hedhur në kutinë e votimit fletën e votimit ose në mënyrë elektronike*”. Pra, në Rregullore nuk shkruhet shprehimisht se mund të votohet me “atë impiantin ekzistues të Kuvendit”, por shkruhet në përgjithësi “në mënyrë elektronike”, pra me një impiant elektronik që siguron fshehtësinë. Nuk ka mundësi që deputetët tanë të nderuar, të kenë miratuar me konsensus, edhe të PD-së dhe edhe të PS-së, një Rregullore që legalizon mashtrimin, pra, me siguri e kanë pasur fjalën jo për këtë aktualin, që gjithnjë është ditur se si është, por për një impiant elektronik të fshehtë që do të blihej nga Kuvendi, ose fundja “që do te modifikohej siç duhet nga Kongresi Amerikan”, siç i shkoi mendja të thotë kryeministrit tonë, sapo erdhi “kryetarja” nga Amerika?! (Ku e gjetën xhanëm, tamam Kongresin Amerikan, ku votimi i fshehtë praktikisht nuk ekziston, si rezultat i sistemit të tyre krejt ndryshe me tonin, mentalitetin amerikan demokrat, që është me qindra vjet larg mentalitetit tonë prej të korruptuari politik?! Apo mos ka edhe këtu ndonjë shejtanllëk, ndonjë mashtrim të radhës?! Po le t’i lëmë qesënditë.

Sipas arsytimit logjik:

Rregullorja është një marrëveshje, apo një kontratë, që, si gjithë të tjerat, do interpretuar. Ne po e interpretojmë duke përdorur principet e thjeshta të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, meqë na duket se janë veçanërisht të shprehura mirë.

“*Kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve ...*”—shkruhet në nenin 681 të KC. Qëllimi i vërtetë i palëve, kur kanë bërë Rregulloren e Kuvendit, ka qenë që të sigurohet fshehtësia e votimit. Nuk ka kuptim të merremi me kuptimin letrar të fjalës “elektronike”, nëse atë e lidhim me impiantin aktual, që tashmë dihet se nuk siguron “qëllimin e vërtetë i palëve”, pra votimi i fshehtë. Ky është konkluzioni i parë logjik.

Kur ... kontrata mbetet e errët, kjo duhet të merret në kuptimin më pak të rënduar për të detyruari ... dhe në kuptimin që realizon përputhjen e interesave të palëve në mënyrë të paanshme—neni 689 i KP. Pra, nëse mbetet e errët se a është apo jo i fshehtë impianti aktual elektronik i Kuvendit, duhet të merret kuptimi më pak i rënduar për “të detyruarin”, pra për minorancën (opozitën), apo fundja të merret në kuptimin që realizon përputhjen e interesave të

maxhorancës dhe minorancës në mënyrë të paanshme. Pra, duhet “të merret se impianti aktual nuk është i fshehtë”, dhe të kalohet në votim me kuti, sepse ky “realizon përputhjen e interesave të të gjitha palëve”. Ky është konkluzioni i dytë dhe i fundit, i logjikës.

Edhe në legjislacionin e huaj të pranuar gjerësisht, thuhet se “nëse është i qartë qëllimi i vërtetë i palëve (intent-anglisht), atëherë principet e interpretimit të kontratës (Rregullores, apo ligjit), bazohen mbi këtë qëllim, dhe jo në fjalë, apo veprime, apo ngjarje të veçanta”. Duke zbatuar këto principe për rastin që diskutohet, rezulton se fakti që përpara janë bërë votime të fshehta me këtë impiant, pra ka pasur ngjarje të tilla, të cilat tani po na i numërojnë sofistët, nuk është argument për të vazhduar në gabim.

* * *

Megjithatë, pavarësisht sa thamë, tani që plasi ky skandal, ia vlen që të amendohet (ndryshohet) Rregullorja e Kuvendit, duke i hequr fare ato fjalët “mënyrë elektronike”, derisa Kuvendi të arrijë të blejë një impiant elektronik që siguron fshehtësinë njësoj si votimi me kuti!

Bashkim Kopliku

Durrës, më 7.3.2006